



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**K.P.P. 120/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alpen Pulito” shpk nga procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78532-11-12-2020, me objekt “Dezinfektim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit dhe Poliklinika Lushnje për situatën e krijuar nga Covid -19” me fond limit 8 333 333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.

**Ankimues:** “Alpen Pulito” shpk  
Lagjia nr.14, Rr. “Tirana”, Shkozet, Durrës

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje  
Lagjia Xhevdet Nepravishta, Lushnje

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin

e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.11.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me nr. *REF-78532-11-12-2020*, me objekt “*Dezinfektim i*

*ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit dhe Poliklinika Lushnje për situatën e krijuar nga Covid -19” me fond limit 8 333 333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.*

II.2. Në datën 19.01.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 05.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “NRG” shpk	5 758 983.00 lekë	I skualifikuar
- BOE “Loerma” shpk & “V.A.L.E Recycling” shpk	5 843 260.8 lekë	I skualifikuar
- “Pastrime Silvio” shpk	4 682 100 lekë	I kualifikuar
- “Egian Med” shpk	4 689 000 lekë	I skualifikuar
- “Alpen Pulito” shpk	4 215 809.661 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 08.02.2021 operatori ekonomik “Alpen Pulito” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e ofertës së tij me argumentet si më poshtë:

*[...]Shoqëria “Alpen Pulito” shpk (këtu e në vijim OE ankimues) ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit dhe Poliklinika Lushnje për situatën e krijuar nga Covid -19” të organizuar nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.*

*Nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (këtu e në vijim SPE) Oe ankimues me datë 05.02.2021 është njoftuar për skualifikimin dhe renditjen e OE ekonomik të tjerë pjesëmarrës si më poshtë:*

- “Alpen Pulito” shpk	4 215 809.66 lekë	I skualifikuar
- “Pastrime Silvio” shpk	4 682 100.00 lekë	I kualifikuar

.....[ ]

*Fillimisht sqarojmë se oferta e paraqitur prej OE ankimues është ajo më me leverdi ekonomike për autoritetin kontraktor.*

*Arsyeja e skualifikimit të ofertës tonë është:*

*1.Xhiro mesatare e tre viteve te fundit nuk ka objektin e prokurimit për të cilën realizohet procedura nga operatori ekonomik, por është për një procedurë të realizuar me një operator tjetër.*

2. Ofertuesi duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë për të paktën 6 muajt e fundit, për këtë ai ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me një operator tjetër për masat kundër zjarrit të ndërtesave të çdollos si dhe një kontratë për një punonjës të punësuar si teknik dezinfektimi.

Duke vlerësuar se arsyet e skualifikimit të ofertës tonë janë në kundërshtim me kriteret e parashikuara në DST, ligjin dhe dokumentacionin e ngarkuar në SPE, paraqesim këtë ankesë përsa më poshtë vijon:

Lidhur me arsyen e parë për skualifikim:

Xhiro mesatare e tre viteve të fundit nuk ka objektin e prokurimit për të cilën realizohet procedura nga operatori ekonomik, por është për një procedurë të realizuar me një tjetër operator ekonomik.

Në DST nga AK është kërkuar:

- Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga Dega e Tatim Taksave duke kërkuar të specifikohet emri i procedurës së prokurimit, pra është kërkuar thjeshtë paraqitja e këtij dokumenti pa asnjë përcaktim tjetër të veçantë apo specifik ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AK-së nuk qëndron dhe një kriter i pa kërkuar në dokumentet e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumente shtesë të pa kërkuara nga autoriteti kontraktor të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE ankimes. Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit e rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet vetëm në përputhje me këto kërkesa.

Në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë apo vlerësojë një ofertë tej atyre të parashikuara në DST. Kriteret e parashikuara në DST janë kufiri maksimal i kriterëve të kërkuara nga AK dhe çdo konstatim apo kërkim i AK-së tej atyre të parashikuara në DST është në kundërshtim me ligjin dhe absolutisht i pavlefshëm.

*Sa më sipër, lehtësisht dallohet se veprimet e kryera nga KVO kanë shkelur parimet e ligjshmërisë dhe të barazisë të sanksionuara si në LPP edhe në Kodin e Procedurave Administrative.*

*Parimi i ligjshmërisë është një ndër parimet kryesore të veprimitarisë së organeve të administratës publike ( Neni 9 i K.Pr Administrative). Gjithashtu ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit të parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij janë ato të mosdiskriminimit, transparencës, barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtë me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.*

*Sa më sipër pretendimi i AK-së nuk qëndron.*

*Lidhur me arsyen e dytë për skualifikim*

*Ofertuesi duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë për të paktën 6 muajt e fundit, për këtë ai ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me një operator tjetër për masat kundër zjarrit të ndërtesave të çdolloj si dhe një kontratë për një punonjës të punësuar si teknik dezinfektimi.*

*Në DST nga AK (referuar edhe shtojcës nr. 2) është kërkuar:*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një punonjës të kualifikuar për trajtimin e sigurisë në punë (për të cilën të paraqesë certifikatën e trajnimeve) i cili duhet të bëjë trajnimin teknike të punonjësve të tij mbi masat dhe sigurisë në punë i cili duhet të figurojë në listëpagesat e E-sig minimalisht për periudhën Tetor 2020 ose të paraqesë një kontratë me persona apo shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi.*

*Nga OE ankimues në sistem është ngarkuar;*

*Certifikatë në emër të z. Alekt Alibesi me objekt “ Përgjegjës dhe specialist për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë” e shoqëruar me kontratën individuale të punës nga ku rezulton se ky punonjës ka një periudhë punësimi pranë OE ankimues rreth 6 vite duke e tejkuluar disa fish kriterin lidhur me periudhën e sigurimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.*

*Në neni 46 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

*Sa më sipër lehtësisht dallohet se veprimet e kryera nga KVO kanë shkelur parimet e ligjshmërisë dhe të barazisë të sanksionuara si në LPP edhe në Kodin e Procedurave Administrative.*

*Parimi i ligjshmërisë është një ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike ( Neni 9 i K.Pr Administrative). Gjithashtu ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit të parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij janë ato të mosdiskriminimit, transparencës, barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtë me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.*

*Sa më sipër, pretendimi i Autoritetit Kontraktor nuk qëndron.*

*Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët si dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale aq më tepër në kushtet kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri që operatori ekonomik ankimues e disponon.*

*Për sa më sipër përfundimisht kërkojmë pranimin e ankesës dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur prej nesh në këtë procedurë prokurimi.”*

II.6. Në datën 10.02.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës me argumentet se: “[...]I-Në lidhje me pretendimin e parë për xhiron mesatare, ju keni paraqitur xhiron mesatare të tre viteve për llogari të një subjekti tjetër konkretisht Drejtorisë të Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë. Vërtetimi të cilin kemi kërkuar printohet nga sistemi, pra nuk ka arsye të mos paraqitet vërtetimi i saktë qoftë edhe pa specifikuar emër autoriteti kontraktor (Në rast se nuk do të kishte emër specifik të ndonjë AK, vërtetimi do të konsiderohej i vlefshëm.)

*Për sa më sipër pretendimi nuk qëndron.*

2- *Për sa i përket pretendimit të dytë, ju keni paraqitur certifikatën e punonjësit në përputhje me kriterin e vendosur nga AK.*

*Z. Alket Alibesi punonjës pranë “Alpen Pulito” zotëron certifikatë “Përgjegjës dhe Specialist për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.”*

*Për sa më sipër pretendimi qëndron*

*Procedura do të vazhdojë në bazë të legjislacionit në fuqi.”*

II.7. Në datën 18.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime që ka paraqitur në Autoritet Kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.226/1 prot, datë 26.02.2021 protokolluar me tonën me nr. 264/2 prot datë 01.03.2021 me objekt “Kthim përgjigje shkresës nr.226 prot.,” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alpen Pulito” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Xhiroja mesatare e tre viteve të fundit nuk ka objektin e prokurimit për të cilën realizohet procedura nga operatori ekonomik, por është për një procedurë e realizuar me një operator tjetër” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të modifikuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2 të dokumentave të tenderit, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë:

*Xhiroja mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit.*

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përmbushje të kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit (2017,2018,2019) nr. T03170531, datë 22.11.2020 të vulosur elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës ku shuma për secilin vit është me e madhe se 40% e fondit limit të procedurës.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*.

Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet: *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”*.

Ndërsa në nenin 26, pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në respekt të nenit 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.



III.1.6. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk është kërkuar si një detyrim ligjor për tu përmbushur nga ofertuesit paraqitja e vërtetimit të xhiros mesatare të realizuar për tre vitet e fundit (2017,2018,2019) ku të përcaktohet në mënyrë të shprehur procedura konkrete e prokurimit. Autoriteti Kontraktor është mjaftuar me kriterin e paraqitjes nga operatorët ekonomik të: “ *Xhiros mesatare të realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit* ”si një kusht i domosdoshëm për kualifikim i përmbushur nga operatori ekonomik përmes dorëzimit të vërtetimit nr. T03170531, datë 22.11.2020 të vulosur elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës . Në këtë mënyrë Komisioni gjykon se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues “Alpen Pulito” sh.p.k nga procedura e prokurimit është mbështetur në kritere të papërcaktuara ligjore.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kritereve, si dhe nuk duhet të përdorin kritere që nuk janë të përcaktuara në dokumentet e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alpen Pulito” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “*Ofertuesi duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë për të paktën 6 muajt e fundit, për këtë ai ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me një operator tjetër për masat kundër zjarrit të ndërtesave të çdolloj si dhe një kontratë për një punonjës të punësuar si teknik dezinfektimi*” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 të modifikuar të dokumenteve të tenderit “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1/d është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një punonjës të kualifikuar për trajtimin e sigurisë në punë (për të cilën të paraqesë certifikatën e trajnimeve) i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat dhe sigurinë në punë i cili duhet të figurojë në listëpagesat e E-sig minimalisht për periudhën Tetor 2020 ose të paraqesë një kontratë me persona apo shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi.”*

III.2.2. Në kthimin e përgjigjes lidhur me këtë pretendim autoriteti kontraktor ka argumentuar se *“Për sa i përket pretendimit të dytë, ju keni paraqitur certifikatën e punonjësit në përputhje me kriterin e vendosur nga AK. Z. Alket Alibesi punonjës pranë “Alpen Pulito” zotëron certifikatë “Përgjegjës dhe Specialist për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë. Për sa më sipër pretendimi qëndron”* duke përmbushur në këtë mënyrë pretendimin e ankimuesit dhe si rrjedhim ky pretendim nuk merret në shqyrtim nga KPP.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk merret në shqyrtim.

III.3. Për arsyetimin më lart, K.P.P e gjykon të pabazuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alpen Pulito” shpk dhe ky vendim duhet anuluar si një vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik në kuptim të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:*

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;*
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;*
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;*
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”.*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri :

## **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78532-11-12-2020, me objekt “Dezinfektim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit dhe Poliklinika Lushnje për situatën e krijuar nga Covid -19” me fond limit 8 333 333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së datë 05.02.2021 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.264 Protokoli, Datë 18.02.2021**

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**